

L I G J
Nr.7846, datë 21.7.1994

PËR NDËRTIMIN, ADMINISTRIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E
SISTEMEVE UJITËSE DHE KULLUESE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Sistem ujitës dhe kullues është çdo ndërtim hidroteknik që shërben për ujitjen e kullimin ose mbrojtjen e një sipërfaqe të tokës bujqësore.

Neni 2

Sistemet ujitës e kullues përbëhen nga objekte siç janë: digat mbi lumenjtë dhe të ujëmbledhësave, pendët mbrojtëse gjatësore dhe tërthore të ndërtuara gjatë lumenjve, përrenjve të sistemuar ose pritëse të ujërave të larta, stacionet e pompimit të ujitjes dhe kullimit, rrjeti i kanaleve ujitës dhe kullues të ndërtuara për ujitje dhe kullimin e tokave bujqësore si edhe objekte të tjera të këtij sistemi.

Neni 3

Sistemet ujitës dhe kullues përbëhet nga objekte kryesore e të brendshëm.

1. Në objekte kryesore përfshihen:

a) kanalet ujitës e kullues që shërbejnë për të ujitur ose kulluar një sipërfaqe toke bujqësore në zonën fushore më të madhe se 200 ha dhe në zonën kodrinore e malore më të madhe se 100 ha;

b) stacionet e pompimit të ujitjes të ndërtuara mbi kanale ujitës të përmendura në pikën “a” si dhe stacionet e furnizimit me ujë të ujëmbledhësave së bashku me linjat elektrike e telefonike dhe nënstacionet që shërbejnë në mënyrë të veçantë për këto stacione;

c) stacionet e pompimit të kullimit (hidrovoret) së bashku me linjat elektrike e telefonike si edhe nënstacionet përkatëse të tyre;

d) rrugët që janë ndërtuar në kuadrin e ujitjes dhe të kullimit dhe kur ato nuk shërbejnë si rrugë nacionale;

e) pendët gjatësore e tërthore të lumenjve e përrenjve të sistemuar që shërbejnë për mbrojtjen e tokave bujqësore e të qendrave rurale;

f) digat mufatëse të lumenjve që shërbejnë për kthimin e ujit në sistemet ujitës, digat e ujëmbledhësve së bashku me strukturat përkatëse të tyre;

Në objektet e mësipërme janë pjesë përbërëse dhe të pandashme prej tyre të gjitha veprat e artit dhe strukturat e ndërtura në to.

2. Në objekte të brendshëm përfshihet i gjithë rrjeti ujitës e kullues më i vogël se ai i përfshirë në pikën 1, së bashku me veprat e artit përkatëse të ndërtuara mbi to.

Neni 4

Drejtoritë e ujërave të rretheve janë ndërmarrje të specializuara për administrimin,

mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve të ujitjes e kullimit në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

KREU II DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 5

Burimet ujore të lumenjve, përrenjve, liqeneve natyrore, të ujëmbledhësave, ujërave nëntokësorë dhe ujërat e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit që përdoren për ujitjen e tokave bujqësore janë pronë e shtetit.

Neni 6

Me qëllim që të bashkërendohet përdorimi i burimeve ujore, autorizimi ose leja për përdorimin e pasurive ujore kombëtare edhe për nevojat e bujqësisë jepet nga organi i veçantë i caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

Sistemet ujitëse dhe kulluese dhe objektet mbrojtëse mund të administrohen nga drejtoritë e ujërave, nga shoqatat e përdorimit të ujit dhe nga persona të tjerë fizikë e juridikë. Kalimi i administrimit të sistemeve ujitëse dhe kulluese nga një formë në një tjetër bëhet me propozim të rrethit përkatës dhe me miratim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 8

Ndërtimi i veprave ujitëse dhe kulluese bëhet në përputhje me ligjet në fuqi për ngritjen e objekteve të tjera ndërtimore.

Ndërtimi i çdo sistemi të ri ujitës e kullues ose ndryshime në sistemet ekzistuese që kryhen nga shoqatat e përdorimit të ujit ose nga persona të tjerë fizikë e juridikë bëhet me leje të Drejtorive të Ujrave të rretheve.

Neni 9

Drejtoritë e ujërave të rretheve administrojnë sistemet kryesore ujitëse dhe kulluese. Në këto sisteme kanalet kulluese dhe ujitëse kryesore, stacionet e pompimit të ujitjes e kullimit dhe veprat e artit me strukturat e tjera përkatëse mirëmbahen dhe shfrytëzohen me shpenzimet e drejtorive të ujërave, kurse kanalet ujitëse e kulluese të brendshme me veprat përkatëse të artit mirëmbahen e shfrytëzohen me shpenzimet e tyre nga shoqatat e përdorimit të ujit që përfitojnë prej këtyre sistemeve. Përdoruesit e ujit që marrin ujë nga këto sisteme paguajnë tarifën e ujitjes.

Reabilitimi i sistemit ujitës të të gjitha niveleve të dëmtuara, të bëhet me investime shtetërore nëpërmjet Drejtorive të Ujrave.

Neni 10

Në sistemet ujitëse që shërbejnë edhe për furnizimin me ujë të hidrocentraleve, kanalet furnizuese të hidrocentralit dhe veprat e artit përkatëse mbi to, mirëmbahen nga ndërmarrjet energjetike. Çdo ndryshim në këto sisteme bëhet me lejen e ndërmarrjes së ujërave, pa prekur regjimin e shfrytëzimit të ujit për nevojat e bujqësisë.

Neni 11

Sistemet e vogla të pavarura ujitëse (rezervuarë të vegjël, vijë ujitëse, stacione pompimi etj.), që i kalojnë për administrim vetëm një shoqate të përdorimit të ujit, mirëmbahen e shfrytëzohen nga

vetë shoqata e përdorimit të ujit me shpenzimet e saj.

Neni 12

Sistemet e vogla ujitëse e kulluese të pavarura që ndodhen në territorin ku e zhvillojnë veprimtarinë persona juridikë e fizikë, administrohen nga vetë këta persona.

KREU III SHOQATA E PËRDORIMIT TË UJIT

Neni 13

Shoqatat e përdorimit të ujit krijohen nga vetë përdoruesit e ujit në bazë fshati, sistemi ujitës ose të një sistemi të vogël ujitës. Komunitet dhe drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në rreth, në interes të përdorimit më mirë të ujit, të mirëmbajtjes së kanaleve ujitëse dhe kulluese, ose kur është e nevojshme të parandalohen konfliktet ndërmjet përdoruesve të ujit, kanë të drejtë të krijojnë shoqata të përdorimit të ujit. Statuti tip do të jetë i njëjtë me atë të shoqatave që krijohen nga vetë anëtarët

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përgatit statutin tip dhe rregulloren e shoqatave të përdorimit të ujit, që shërbejnë për themelimin e shoqatave të përdorimit të ujit.

Shoqatat e përdorimit të ujit dërgojnë statutin e tyre në drejtorinë e bujqësisë e të ushqimit në rreth dhe, pas miratimit prej saj, shoqata regjistrohet në gjykatën kompetente dhe që këtu ajo fiton zotësi juridike.

Shoqatat janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji, statutin e rregulloren e shoqatave të përdorimit të ujit.

Shoqatat e përdorimit të ujërave ngrenë juri, të cilat zgjidhin konfliktet dhe gjykojnë shkeljen administrative në territorin ku e shtrin veprimtarinë shoqata. Juritë kanë kompetencë të plotë të vendosin dënimet përkatëse ndaj kundravajtjeve administrative të ligjit dhe të statutit e rregullores së shoqatës, që kryhen nga persona të ndryshëm.

Neni 14

Komuna ose rrethi kur shoqata e përdorimit të ujit shtrihet në dy ose më shumë komuna, ka këto të drejta:

- a) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të gjykimeve të jurive të krijuara nga shoqatat e përdorimit të ujit;
- b) të caktojë një përfaqësues në këshillin drejtues të një shoqate të përdorimit të ujit;
- c) të bëjë mbledhjen e përgjithshme, nëse drejtori i këshillit drejtues ose shumica e anëtarëve nuk e bëjnë;
- ç) të shpërndajë këshillin drejtues të një shoqate të përdorimit të ujit dhe të caktojë një drejtues të përkohshëm, për të drejtuar shoqatën, derisa të krijohet një këshill i ri drejtues.
- d) të shpërndajë një shoqatë të përdorimit të ujit;
- dh) të miratojë statutet e grupeve të shoqatave të formuara nga kombinimi i shoqatave individual.

KREU IV MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE UJITËSE DHE KULLUESE

Neni 15

Drejtoritë e ujërave, shoqatat e përdorimit të ujit dhe personat juridikë e fizikë mirëmbajnë me shpenzimet e tyre sistemet ujitëse e kulluese që u lihen në administrim.

Neni 16

Shpenzimet e shfrytëzimit e të mirëmbajtjes së sistemeve ujitëse dhe kulluese në administrimin e ndërmarrjeve të ujërave përballohen me të ardhurat nga ujitja që paguhet nga përdoruesit e ujit dhe, kur del e nevojshme, edhe me fonde të veçanta nga shteti.

Neni 17

Shoqatat e përdorimit të ujit dhe personat e tjerë juridikë e fizikë, në këto sisteme janë të detyruara që brenda territorit të tyre të mirëmbajnë në kushtet e projektit kanalet ujitëse e kulluese të brendshme, bashkë me veprat e artit përkatëse. Drejtoritë e ujërave kanë të drejtë t'u kërkojnë shoqatave të përdorimit të ujit dhe personave të tjerë juridikë e fizikë të kryejnë punime me shpenzimet e tyre, për të aftësuar objektet e tyre që kanë në administrim, si edhe të marrin masa që brenda territorit të tyre të shmangin keqpërdorimin e ujit, përmytjet, kapërcimin e bankinave të kanaleve, erozionin e tokës dhe ndotjet e burimeve ujore.

Drejtoritë e ujërave kanë kompetencë të ndërpresin furnizimin me ujë, derisa të plotësohen punimet e mësipërme.

Neni 18

Mirëmbajtja e sistemeve të ujitjes e të kullimit nga ndërmarrjet e ujërave dhe shoqatat e përdorimit të ujit bëhet në afatet e caktuara, me qëllim që sistemi ujitës të jetë në shfrytëzim të plotë në fillim e gjatë stinës së ujitjes dhe sistemi kullues në fillim e gjatë periudhës së dimrit.

Afatet për vënien në gatishmëri të veprave të ujitjes dhe kullimit caktohen në varësi nga kushtet e çdo veprë.

Punimet vjetore për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit kryhen me kontratë, në bazë të një grafiku të miratuar nga ndërmarrjet e ujërave dhe shoqatat e përdorimit të ujit.

Anëtarëve të shoqatave të përdorimit të ujit u lind e drejta e kompensimit nga ndërmarrjet e ujërave, në qoftë se nga punimet e paparashikuara ose jashtë kontratës të kryera nga ndërmarrjet e ujërave shkaktohen dëme në kulturat bujqësore ose në pronën e anëtarëve të fituar sipas ligjit.

Masa dhe vlera e dëmit caktohet nga një komision i përbërë nga përfaqësues të komunës, drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit, shoqata e përdoruesve të ujit dhe drejtoria e ujërave.

KREU V SHFRYTËZIMI I SISTEMEVE TË UJITJES DHE KULLIMIT

Neni 19

Drejtoritë e ujërave, shoqatat e përdorimit të ujit, personat juridikë e fizikë shfrytëzojnë sistemet ujitëse e kullues që u lihen në administrim.

Neni 20

Drejtoritë e ujërave sigurojnë furnizimin me ujë të shoqatave të përdorimit të ujit dhe personave të tjerë juridikë e fizikë, në bazë të kontratave tip të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Fermerët që nuk bëjnë pjesë në shoqata i paguajnë ndërmarrjes së ujërave tarifën e ujitjes 50 për qind më të lartë.

Shpërndarja e ujit brenda territorit të shoqatës për gjithë përdoruesit e ujit bëhet nga vetë shoqata.

Neni 21

Furnizimi i sistemeve ujitës nga burimet ujore natyrore, si lumenj, liqene, përenj, burime etj. dhe liqeneve të hidrocentraleve, kur nuk është parashikuar ndryshe, bëhet pa pagesë.

Gjithashtu, dhënia e ujit nga një ndërmarrje ujrash në një tjetër ndërmarrje ujrash bëhet pa

pagesë.

Marrja e ujit për nevojat e hidrocentraleve të ndërtuara mbi sistemet ujitëse, kur nuk është parashikuar ndryshe, bëhet pa pagesë.

Kur një sistem ujitës furnizon me ujë më shumë se një rreth, ndërmarrja e ujrave që administron këtë sistem ujitës, është e detyruar të furnizojë të dy rrethet në sasinë e ujit në bazë të sasisë së caktuar në projektin e veprës. Për shfrytëzimin e sistemeve ujitës në këtë rast bëhet një akt marrëveshje e përvitshme ndërmjet ndërmarrjeve të ujërave të rretheve përkatëse.

Neni 22

Në rastet kur burimet ujore që furnizojnë sistemet e mëdha të ujitjes nuk sigurojnë ujë të mjaftueshëm për dy ose më shumë rrethe që furnizohen prej tij gjatë stinës së ujitjes, sasia e ujit shpërndahet ndërmjet rretheve në raport me aftësinë ujitëse të projektuar të çdo rrethi. Kur është e nevojshme që ndarja e ujit të bëhet jo në mënyrë përpjesëtimore, sasi të ujit për çdo rreth caktohen nga drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit të rretheve përkatëse dhe vendoset përfundimisht, kur është e nevojshme, nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Shpërndarja e ujit brenda rrethit për shoqatat e përdorimit të ujit miratohet nga drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit në rreth.

Neni 23

Përdorimi i ujit nga sistemet e ujitjes dhe kullimit për ujitje dhe për qëllime të tjera bëhet në çdo rast me autorizim ose leje administrative. Autorizimi ose leja jepen nga ndërmarrjet e ujërave, pas plotësimit të kushteve të caktuara, dhe mund të anulohen prej saj në rastet e shkeljeve ose të mosplotësimit të këtyre kushteve.

Neni 24

Pronarët dhe përdoruesit e tokës janë të detyruar që nëpër pronat e tyre të lejojnë rrjedhjen pa pengesë të ujit për ujitjen dhe për kullimin në kanalet që përshkojnë tokën e tyre.

Drejtoritë e ujrave dhe shoqatat e përdorimit të ujit kanë në kompetencë të vendosin në pronën e të tjerëve, brenda juridiksionit të tyre, çdo të drejtë për kalim dhe përdorimi uji, ndërtimin e kanaleve dhe të drenave si dhe çdo ndërtim tjetër që lidhet me ujitjen dhe kullimin. Pronarët dhe përdoruesit e tokës ku kryhen këto punime, kanë të drejtën e vlerësimit e të pagimit për kompensim të dëmit, kur pronën e kanë fituar në përputhje me ligjin.

Neni 25

Kur si pasojë e keqpërdorimit të ujit, vijnë prurje më të mëdha se ato të parashikuara, ose ka ndotje të tij, pronari i tokës, që është në vazhdim të rrjedhjes së ujrave pëson dëm, ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga pronari që e ka shkaktuar atë. Përfshihen rastet kur dëmi ka ardhur si pasojë e një force madhore (veprime të natyrës ose veprime të shkaktuara nga një palë e tretë).

Gjithashtu, pronari ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit, kur për faj të pronarit që ndodhet para tij i ndërpritet ose i pakësohet sasia e ujit të caktuar për të, nuk mirëmbahet rrjeti ujitës dhe kullues dhe nga këto i janë shkaktuar dëme.

Vlerësimi dhe shpërblimi i dëmit bëhet nga një komision i ngritur nga juria e shoqatës së përdorimit të ujit.

KREU VI TARIFAT E UJIT

Neni 26

Të gjithë përdoruesit e ujit janë të detyruar të zbatojnë rregullat e Ministrisë së Bujqësisë dhe

Ushqimit për pagesat e tarifave të ujitjes të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Të gjithë përdoruesit e ujit janë të detyruar të paguajnë 30 për qind të tarifave vjetore të ujit, kur nënshkruhet kontrata ndërmjet tyre dhe ndërmarrjes së ujërave. Pagesa e mbetur bëhet siç është caktuar në kontratë. Pagesa përfundimtare bëhet në fund të sezonit të ujitjes.

Kur drejtoritë e ujërave nuk furnizojnë me sasinë e ujit në kohën e caktuar në kontratë, shoqata ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar përdoruesve. Përfshihen vetëm rastet që vijnë për fuqi madhore ose për mungesë të ujit në burimet ujore që furnizojnë sistemet ujitëse.

Neni 27

Furnizimi me ujë i përdoruesve të tij nga sistemet ujitëse dhe kulluese që administrohen nga ndërmarrjet e ujërave, bëhet me pagesë në bazë të sasisë së ujit që merr çdo përdorues.

Shoqatat e përdoruesve të ujit në këtë rast mbledhin të ardhurat nga anëtarët e saj dhe i kalojnë në interes të ndërmarrjeve të ujërave.

Furnizimi me ujë nga sistemet që u janë lënë në administrim shoqatave të përdorimit të ujit për anëtarët e saj, bëhet pa pagesë. Anëtarët e shoqatës në këtë rast derdhen një kuotë për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve.

Neni 28

Tarifat e ujit që paguhet nga përdoruesit e ujit drejtorisë së ujërave, caktohen nga Këshilli i Ministrave

KREU VII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 29

Përbëjnë kundërvajtje administrative, kur nuk formojnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme që kryhen në sistemet ujitëse e kulluese të administruara nga drejtoritë e ujërave:

- a) ndërtimi i veprave ujitëse ose kulluese pa autorizimin ose lejen përkatëse;
- b) shkaktimi i dëmeve në veprat ujitëse e kulluese, duke ndryshuar regjimin e rrjedhjes së ujit;
- c) marrja e ujit pa autorizim të ndërmarrjes së ujërave;
- ç) shkelja e kushteve të autorizimit ose lejes së dhënë nga ndërmarrjet e ujërave, duke shkaktuar dëme në pronën shtetërore ose të personave juridikë ose fizikë;
- d) bllokimi ose ndryshimi i kanaleve ujitëse apo kulluese dhe strukturave përkatëse pa autorizim të ndërmarrjeve të ujërave;
- dh) përdorimi i pompave ose pajisjeve të tjera për nxjerrjen e ujit nga kanalet ujitëse apo kulluese në vende të tjera nga ato të përcaktuara në kontratë;
- e) shkaktimi i dëmtimeve nga diga, kanale e drena;
- ë) nxjerrja e materialeve ndërtimore nga shtretërit e lumenjve nga zonat e ndaluara;
- f) shkaktimi i ndotjes së ujit në kanalet ujitëse e kulluese nga një shkarkim i paautorizuar i papastërtive në to;
- g) mbjellja e pemëve përgjatë argjinaturës së lumejve, digave, kanaleve e drenave jashtë vendeve të lejuara;
- gj) ndërtimi i gardheve përgjatë dhe brenda kanaleve ujitëse e kulluese;

Neni 30

Kundërvajtjet administrative sipas nenit 29 të këtij ligji shqyrtohen nga drejtori i ndërmarrjes së ujërave dhe dënohen me gjobë në masën nga 1000 deri në 10 000 lekë.

Për konstatimin e kundërvajtjes administrative mbahet procesverbal nga përfaqësuesit e autorizuar të drejtorive të ujërave në rrethe.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të vendimit, në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

Ekzekutimi i vendimeve të dënimit bëhet sipas ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, të shkaktuara në territorin e shoqatës së përdorimit të ujit nga anëtarët e saj ose persona të tjerë do të gjykohen nga juria e zgjedhur e shoqatës për anëtarët e saj dhe nga komuna për personat e tjerë dhe dënimet ndaj kundërvajtësit vendosen në përputhje me statutin e shoqatës.

Ankimi kundër vendimit të dënimit dhe ekzekutimit bëhen sipas nenit 13 të këtij ligji.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Dekreti nr.4311, datë 8.9.1967 “Për ndërtimin dhe administrimin e veprave të kullimit dhe ujitjes”, dekreti nr.567, datë 28.6.1993 “Për transferimin e disa veprave ujitëse e kulluese në administrimin e komunave”, si edhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 33

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.908, datë 16.8.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha